

Financimi i sistemit gjyqësor

Konfigurimi i ri i hartës gjyqësore dhe sfidat buxhetore

Mars 2025

Tabela e lëndës

I.	Trendet në shpenzimet për sektorin e drejtësisë.....	3
II.	Struktura e shpenzimeve.....	5
III.	Kriteret për shpërndarjen e buxhetit.....	6
IV.	Përdorimi i treguesve të performancës dhe kriteret për financim në pushtetin gjyqësor	9
V.	Harta e re gjyqësore dhe implikimet e saj.....	11
VI.	Përfundime	15

I. Trendet në shpenzimet për sektorin e drejtësisë

Përcaktimi i buxhetit është një nga çështjet më sensitive për të cilat është përgjegjëse një qeveri. Burimet buxhetore janë të kufizuara në parim dhe prioritizimi i shpërndarjes së tyre krijon dhe një lloj konkurrence mes institucioneve të ndryshme publike: shpërndarja e më shumë fondeve në një sektor përkthehet detyrimisht në më pak burime për sektorë të tjerë. Për sa i përket sistemit të drejtësisë, alokimet e buxhetit bëhen edhe më delikate pasi pushteti gjyqësor është një nga tre pushtetet themelore dhe pavarësia e tij duhet të garantohet. Megjithatë, financimi i gjyqësorit, i cili është mjeti për të materializuar qëllimet dhe – eventualisht – për të siguruar pavarësinë e tij, është në kompetencën e pushtetit ekzekutiv dhe atij legjislativ. Ndarja e pushteteve është një parim kyç për të shmangur përqendrimin e pushtetit në një degë të vetme të shtetit. Megjithatë, kompetenca vendimmarrëse për shpërndarjen e burimeve financiare përbën një instrument të rëndësishëm që mund të kthehet në faktor fuqizues apo pengues për të siguruar këtë pavarësi.

Shpenzimet për sektorin e drejtësisë, janë rritur në mënyrë të konsiderueshme në veçanti që prej vitit 2018, me përshpejtimin e zbatimit të procesit të reformës në drejtësi. Deri në vitin 2018, shpenzimet për drejtësinë si përqindje ndaj PBB-së (0.27%) ishin ndjeshëm nën vlerën mesatare të shpenzimeve për sistemin e drejtësisë në vendet e Europës (0.33% në vitin 2018, CEPEJ 2018). Në vitin 2024 për këtë sektor u shpenzua rreth 0.47% e PBB, ndërkohë që buxheti i akorduar për vitin 2025 parashikon që pesha e drejtësisë të shkojë afër 0.5% të PBB-së. Krahësuar me vendet e BE-së, ky tregues është dukshëm mbi mesataren e shpenzimeve për drejtësinë në vendet e BE-së për vitin 2024 (0.31% në 2024, CEPEJ)¹.

Si përqindje e shpenzimeve të përgjithshme publike, pesha e sektorit të drejtësisë në shpenzimet e qeverisjes së përgjithshme gjithashtu është rritur në mënyrë të ndjeshme, nga 0.86% në vitin 2014, në 1.57% në vitin 2023 (buxheti i zbatuar). Pas një rënije të lehtë relative të shpenzimeve faktike të sektorit të drejtësisë ndaj shpenzimeve të përgjithshme publike në vitin 2024 (1.47%); buxheti i vitit 2025 parashikon rritje në nivele të krahasueshme me vitin 2023 (1.55% ndaj shpenzimeve të përgjithshme). Pesha e shpenzimeve për sistemin gjyqësor megjithatë, është zvogëluar përkundërt totalit të shpenzimeve për drejtësinë përgjatë së njëjtës periudhë, duke rënë nga 58% (2014) në 49% në vitin 2020 dhe 43% në vitin 2024 (buxheti i zbatuar), pavarësisht rritjes së vazhdueshme nominale vjetore.

¹ <https://www.coe.int/en/ëeb/portal/-/efficacit%C3%A9-et-qualit%C3%A9-de-la-justice-en-europe-le-conseil-de-l-europe-publie-son-rapport-2024>

Tabela 1 Shpërndarja e fondeve për institucionet e sistemit të drejtësisë 2014 – 2024

MIn lekë	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025 budget
Gjyqësori										
Keshilli i larte gjyqësor, nga të cilat	2,153.7	2,149.3	2,155.3	2,662.5	2 781,4	2 905,2	3 257,5	4 681,4	4 752,9	6 119,0
Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	26.6	27.5	27.1	142.2	261,9	244,0	249,4	320,5	322,9	470,4
Buxheti gjyqësor	2,127.1	2,121.8	2,128.1	2,520.3	2 519,5	2 661,2	3 006,1	4 355,7	4 417,1	5 628,5
Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë					-	-	2,1	5,2	12,9	20,1
Gjykata kushtetuese	111.9	116.7	102.9	102.3	98,5	131,5	166,7	203,7	300,3	248,0
Shkolla e magjistratures	68.5	89.4	110.7	158.5	170,7	239,9	295,0	460,9	462,6	491,6
Prokuroria e përgjithshme	1,693.0	1,621.2	1,594.8	2,171.8	2 180,4	2 247,0	2 206,0	3 435,0	3 549,6	3 195,9
Keshilli i larte i prokurorisë	63,9	123,7	150,9	149,8	200,9	200,0	206,6	63,9	123,7	150,9
SPAK					167,1	348,7	593,2	1 049,1	1 273,3	2 369,6
KLD/Institucionet e tjera te drejtesise	62.6	124.8	377.0	440.1	416.4	578.6	687.8	1,015.1	1,107.9	
Veprimtaria Gjyqesore (ILD)	62.6	67.3	67.1	44,3	40,2	136,5	155,6	203,6	361,9	354,6
Veprimtaria e rivleresimit kalimtar te magjistratit	0.0	32.2	156.2	197,7	185,9	223,5	258,4	412,9	439,2	-
Veprimtaria e apelimit të rivlerësimit kalimtar	0.0	20.5	107.3	128,6	126,9	149,7	197,1	265,0	297,1	288,0
Veprimtaria e komisionerit publik	0.0	4.8	46.4	69,5	63,4	68,8	76,7	128,7	130,5	-
Grand Total	4,089.8	4,101.5	4,340.6	5 599,2	5 938,0	6 601,8	7 356,0	11 041,1	11 767,3	13 273,3
Shpenzimet e qeverisjes se pergjithshme	433,697	461,410	476,147	491 897	536 279	596 279	651 015	674 857	771 348	825 088
PBB nominale	1,472,479	1,550,645	1,660,821	1 691 727	1 617 541	1 856 172	2 149 741	2 369 906	2 494 208	2 620 732
Ne % te shpenzimeve publike	0.94%	0.89%	0.91%	1,1%	1,1%	1,1%	1,1%	1,6%	1,5%	1,6%
Ne % te PBB-se	0.28%	0.26%	0.26%	0,33%	0,37%	0,36%	0,34%	0,47%	0,47%	0,51%

Burimi: Ministria e Financave, www.financa.gov.al

Krahas rritjes së buxhetit, burimet njerëzore në institucionet e sistemit të drejtësisë kanë pasur një rritje graduale pas fillimit të reformës në drejtësi në vitin 2016. Në total, numri i punonjësve me kohë të plotë në këtë sistem planifikohet të shkojë në 3,637 punonjës në vitin 2025, nga 2345 punonjës që ishte në vitin 2016, ose rreth 55% më shumë (tabela 2). Përveç institucioneve të reja të drejtësisë, peshën kryesore në këtë rritje e zënë sistemi gjyqësor (+538 punonjës) dhe Prokuroria e Përgjithshme (+99 punonjës).

Tabela 2 Numri i punonjësve me kohë të plotë i institucioneve të sistemit të drejtësisë 2016-2024

Emertimi	viti 2016	viti 2017	viti 2018	viti 2019	viti 2020	viti 2021	viti 2022	viti 2023	viti 2024	Viti 2025
Prokuroria e Përgjithshme	863	863	863	928	928	928	958	962	962	962
Keshilli i Larte Gjyqesor	1,354	1,364	1,369	1,493	1,593	1,679	1,729	1,759	1,759	1,892
Gjykata Kushtetuese	54	54	62	62	62	62	62	62	68	73
Shkolla e Magjistraturës	24	27	31	34	35	38	39	40	41	42
Këshilli i Lartë i Drejtësisë	50	50	50	0	0	0	0	0	0	0
Institucionet e SPAK-ut dhe BKH-së	0	0	0	100	100	164	241	271	311	322
Këshilli i Lartë i Prokurorisë	0	0	0	65	65	65	65	72	72	72
Inspektoriati i Larte i Drejtesise	0	0	0	40	93	93	93	101	101	101
Komisioni i Pavarur i Kualifikimit	0	50	50	64	64	76	76	76	76	76*
Kolegji i Posacem i Apelimit	0	37	37	43	43	49	57	57	63	67
Komisioneri Publik	0	26	26	30	30	30	30	30	30	30*
Totali	2,345	2,471	2,488	2,859	3,013	3,184	3,350	3,430	3,483	3,637

Burimi: Ministria e Financave, www.financa.gov.al

* vlerësim në masën e vitit paraardhës

II. Struktura e shpenzimeve

Sistemi i institucioneve të drejtësisë në Shqipëri ka pësuar një rikonfigurim të strukturës së shpenzimeve gjatë viteve të fundit, në linjë me procesin e reformimit të institucioneve të drejtësisë. Struktura e shpenzimeve megjithatë ka ruajtur tiparet e përgjithshme të para reformës, duke u mbizotëruar nga shpenzimet për paga, ndërkohë që shpenzimet kapitale janë shumë modeste, ndonëse në rritje të lehtë nga viti 2020. Ky trend ka vijuar edhe në vitet buxhetin e miratuar për sistemin e drejtësisë për vitin 2025, ku shpenzimet kapitale zënë në përgjithësi më pak se 10% e buxhetit të përgjithshëm të miratuar për secilin nga institucionet. Ndërsa shpenzimet për stafin kanë pësuar një rritje të konsiderueshme ndër vite, shpenzimet për mirëmbajtje dhe shërbime janë rritur në mënyrë më modeste.

Tabela 3 Struktura e shpenzimeve sipas natyrës ekonomike për institucionet e sistemit të drejtësisë

	2020		2021		2022		2023		2024		2025
	Mirat uar	Faktik	Mirat uar	Faktik	Mirat uar	Faktik	Mirat uar	Faktik	Mirat uar	Faktik	Mirat uar
<i>Në mln lekë</i>											
Investime	394	289	560	439	677	527	1 060	492	1 139	905	1 609
Paga për personelin	5 581	4 675	5 868	5 010	6 537	5 448	7 013	8 839	9 042	8 594	9 509
Mirëmbajtje dhe shërbime	993	893	1 164	1 022	1 246	1 143	1 376	1 409	1 590	1 925	1 870
Të tjera	87	81	125	132	182	238	216	302	295	343	284
Gjithsej	7 055	5 938	7 718	6 602	8 642	7 356	9 666	11 041	12 066	11 767	13 273
<i>Në % të totalit</i>											
Investime	5,6%	4,9%	7,3%	6,6%	7,8%	7,2%	11,0%	4,5%	9,4%	7,7%	12,1%
Paga për personelin	79,1%	78,7%	76,0%	75,9%	75,6%	74,1%	72,6%	80,1%	74,9%	73,0%	71,6%
Mirëmbajtje dhe shërbime	14,1%	15,0%	15,1%	15,5%	14,4%	15,5%	14,2%	12,8%	13,2%	16,4%	14,1%
Të tjera	1,2%	1,4%	1,6%	2,0%	2,1%	3,2%	2,2%	2,7%	2,4%	2,9%	2,1%

Burimi: Ministria e Financave, www.financa.gov.al

Kjo dukuri vihet re veçanërisht në buxhetin e sistemit gjyqësor, ku shpenzimet për personelin janë më shumë se dyfishuar në vitin 2024 krahasuar me vitin 2016, ndërkohë që shpenzimet për mirëmbajtje dhe shërbime – ku përfshihen edhe shpenzimet për ekspertë e të tjera të lidhura me proceset gjyqësore, në vitin 2024 janë rritur me rreth 97.1% krahasuar me vitin 2016 (tabela 4). Ndërkohë që shpenzimet kapitale kanë pësuar një rritje relativisht të ulët përgjatë kësaj periudhe, duke shfaqur në shumicën e viteve të marra në analizë një realizim të dobët të tyre krahasimisht me planin buxhetor.

Tabela 4 Struktura e shpenzimeve për buxhetin e gjyqësorit 2016 – 2024

	2016		2017		2018		2019		2020		2021		2022		2023		2024
	Miratuar	Faktik	Miratuar	Faktik	Miratuar	Faktik	Miratuar	Faktik	Miratuar	Faktik	Miratuar	Faktik	Miratuar	Faktik	Miratuar	Faktik	Miratuar
<i>Në mln lekë</i>																	
Buxheti i gjyqësorit	2,220.7	2,127.1	2,158.3	2,121.8	2,271.0	2,128.1	2,350.4	2,520.3	2,912.7	2,758.8	3,153.2	2,883.9	3,478.7	3,233.9	4,848.0	4,661.4	4,912.6
Shpenzime kapitale	239.3	220.3	169.3	138.4	160.0	170.7	159.4	104.7	208.0	112.0	183.0	173.4	385.0	333.7	386.6	351.9	383.0
Shpenzime për personelin	1,635.0	1,480.8	1,610.0	1,535.4	1,740.0	1,514.8	1,770.0	2,006.8	2,234.7	2,209.6	2,439.0	2,249.4	2,490.0	2,336.7	3,692.5	3,607.5	3,689.9
Mirëmbajtje dhe shërbime	346.4	424.4	379.0	444.3	371.0	441.3	421.0	406.7	465.5	434.2	522.4	456.8	574.8	538.7	752.6	695.1	823.9
Të tjera	-	1.6	-	3.7	-	1.4	-	2.2	4.5	3.0	8.9	4.4	29.0	24.8	16.3	6.9	15.8
<i>Në % ndaj totalit</i>																	
Shpenzime kapitale	11%	10%	8%	7%	7%	8%	7%	4%	7%	4%	6%	6%	11%	10%	8%	8%	8%
Shpenzime për personelin	74%	70%	75%	72%	77%	71%	75%	80%	77%	80%	77%	78%	72%	72%	76%	77%	75%
Mirëmbajtje dhe shërbime	16%	20%	18%	21%	16%	21%	18%	16%	16%	16%	17%	16%	17%	17%	16%	15%	17%
Të tjera	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	1%	1%	0%	0%	0%

Burimi: Ministria e Financave, www.financa.gov.al

III. Kriteret për shpërndarjen e buxhetit

Në dekadën e fundit sistemi buxhetor në Shqipëri është transformuar nga modeli historik i bazuar në inputet (artikujt ekonomikë) për planifikimin e buxhetit, në një model që udhëhiqet nga produktet dhe rezultatet e pritshme nga shpenzimet për zbatimin e politikave, ose buxheti me bazë programet dhe performancën. Në strukturën buxhetore, fondet për çdo institucion (ose grup institucionesh) organizohen në programe buxhetore, të cilat (duhet të) lidhen me objektivat strategjikë të organizatës. Programet ndahen më tej në nënprograme/produkte (ose një sërë aktivitesh të

lidhura). Institucionet buxhetore kanë liri për rishpërndarjen e burimeve brenda programeve për të arritur rezultatet e synuara.²

Sipas OECD-së, buxheti me bazë performancën synon të arrijë një sërë qëllimesh. Nga pikëpamja e qytetarëve, një system buxhetor që ka në konsideratë performancën e institucioneve mund të rrisë transparencën dhe llogaridhënien duke qenë se bën lidhje të qarta mes burimeve dhe rezultateve, duke u dhënë mundësi taksapaguesve të vlerësojnë si janë përdorur fondet publike. Nga pikëpamja e qeverisjes, ky system mundëson vendimarrjen buxhetore në bazë të të dhënave të performancës, krahasimin e institucioneve të ndryshme dhe lidhjen e përparësive me fondet. Për më tepër, buxhetimi me bazë performancën mund të nxisë performancën dhe të rrisë eficiencën.

Sistemi i buxhetimit mbi bazë programesh dhe performance, i cili zbatohet në Shqipëri, synon rritjen e eficiencës dhe efektivitetit në përdorimin e fondeve buxhetore nëpërmjet priorizimit të shpenzimeve për sektorët/ dhe politikat prioritare. Financimi lidhet me ciklin e politikave dhe në parim, vendimet për buxhetin merren duke pasur në konsideratë vlerësimin e rezultateve të arritura në secilin program dhe burimeve të nevojshme për t'i arritur ato. Për më tepër, kostot e aktiviteteve të nevojshme për arritjen e objektivave të programeve duhet të paraqiten si pjesë e buxhetit, çka dhe mundëson vlerësimin e efektivitetit (nga pikëpamja e kostos) të programeve apo institucioneve të ngjashme. Në këtë sistem, treguesit e performancës përdoren për të vlerësuar efektivitetin dhe efikasitetin e përdorimit të fondeve publike, si edhe për të peshuar arsyetimet për kërkesën për fonde buxhetore shtesë, por sistemi nuk ka inkorporuar elemente nxitëse apo sanksione sipas performancës.

Buxheti sipas programeve dhe performancës zbatohet zyrtarisht në të gjithë sistemin buxhetor në Shqipëri që prej më shumë se një dhjetëvjeçari. Megjithatë, zbatimi në praktikë ruan ende shumë trajta të sistemit të dikurshëm, të bazuar në planifikimin sipas kostove historike dhe inputeve. Ky tipar vërehet deri diku edhe në buxhetin e sistemit gjyqësor, ku ndonëse sistemi i financimit është lidhur me informacion mbi performancën, cilësia e qasjes së përdorur, treguesve bazë të përdorur dhe lidhja mes informacionit të performancës dhe fondeve të akorduara mbetet nën optimalen. Po ashtu, buxheti hartohet për një periudhë afatmesme trevjeçare (Programi Buxhetor Afatmesëm - PBA). Viti i parë i PBA-së është edhe buxheti vjetor.

Sistemi gjyqësor financohet nga buxheti i shtetit dhe ndjek të gjitha procedurat e hartimit dhe zbatimit të buxhetit të vlefshme për institucionet e qeverisjes së përgjithshme në Shqipëri. Këshilli i Lartë Gjyqësor është përgjegjës për hartimin e buxhetit afatmesëm dhe vjetor, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave. Gjithashtu, KLGJ ka kompetencën e shpërndarjes së fondeve mes gjykatave të ndryshme dhe mbikëqyrjen e shpenzimeve për institucionet e sistemit gjyqësor.

Departamenti i programimit dhe administrimit të buxhetit në KLGJ bën hartimin e programit buxhetor afatmesëm³ për gjyqësorin dhe dorëzon kërkesat buxhetore pranë Ministrisë së Financave. Buxheti i KLGJ-së ndahet në tre programe buxhetore:

² Ka disa kufizime për rishpërndarjen e fondeve midis shpenzimeve korrente dhe atyre kapitale. Institucionet mundet gjithashtu të bëjnë rishpërndarjen e fondeve nëpërmjet programeve të tyre buxhetore, brenda disa kufijve të miratuar me ligj.

³ Në përputhje me ligjin 9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

- Programi i planifikimit, menaxhimit dhe administrimit, nëpërmjet të cilit financohet veprimtaria e vetë KLGJ-së
- Programi i mbështetjes për teknologjinë e sistemit të drejtësisë, nëpërmjet të cilit financohet Qendra e teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë (që nga viti 2021)
- Programi i buxhetit gjyqësor, nëpërmjet të cilit financohet veprimtaria e gjykatave në të tre nivelet, përfshirë edhe gjykatat administrative. Buxheti për Gjykatën Kushtetuese planifikohet dhe menaxhohet drejtpërdrejt nga kjo e fundit dhe nuk përfshihet në buxhetin e KLGJ-së.

Kërkesat buxhetore të hartuara nga KLGJ, në përputhje me nevojat për funksionimin e vetë institucionit dhe gjykatave në tre nivelet, duhet të jenë në përputhje me tavanin buxhetor që përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave në fillim të çdo cikli buxhetor (zakonisht në dy muajt e parë të vitit në vazhdim për vitin pasardhës). Buxheti duhet të financojë minimalisht të gjitha “politikat ekzistuese” (baseline budget) – ose funksionimin normal të institucionit buxhetor dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore të cilat janë miratuar deri në momentin e hartimit të buxhetit. Në parim, taveri buxhetor i caktuar për institucionet duhet t’i ketë marrë parasysh këto kritere. Çdo kërkesë për rritjen e taverit buxhetor, ose për tejkalimin e nivelit të financimit sipas taverit duhet të argumentohet nga institucioni buxhetor si një politikë e re (për shembull në rastin e lindjes së një detyrimi të ri, apo ndryshimit të kriterëve të ofrimit të shërbimit që ndikojnë edhe koston). Financimi i politikave të reja bëhet në bazë të vlerësimit të hapësirës fiskale për vitin buxhetor dhe prioritizimit të rëndësisë relative të politikave të reja. Ky proces, i cili përmbyll edhe “fazën strategjike” të PBA-së, administrohet nga Ministria e Financave, e cila organizon dëgjesa me institucionet buxhetore kryesore dhe përfshin edhe elemente të konsultimit publik. Gjatë fazës së dytë (ose teknike) të PBA-së, në gjysmën e dytë të vitit buxhetor në vazhdim, synohet të kryhen detajime dhe rregullime të nivelit teknik në buxhetin afatmesëm të dakordësuar. Si rregull, në këtë fazë nuk duhet të ketë ndryshime domethënëse në nivelin dhe llojin e financimit të dorëzuar nga ekzekutivi.

Në përmbyllje të fazës teknike të PBA-së, Ministria e Financave dorëzon formalisht projektbuxhetin e shtetit, ku përfshihet edhe buxheti i sistemit të drejtësisë (dhe gjyqësorit) pranë Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, brenda muajit tetor të çdo viti për vitin buxhetor pasardhës. Kuvendi ka të drejtën të bëjë rishpërndatje të fondeve dhe organizon gjithashtu dëgjesa me institucionet përkatëse sipas sektorëve dhe palë të tjera interesi.

Pas miratimit të buxhetit, cikli buxhetor vijon me zbatimin, i cili përfshin akordimin (çeljen) e fondeve dhe menaxhimin e përditshëm të buxhetit. Për buxhetin e sistemit gjyqësor, këtë funksion e kryen KLGJ, e cila kryen shpërndarjen e fondeve ndërmjet gjykatave të ndryshme në përputhje me nivelin e burimeve të tyre dhe monitoron zbatimin e tij. Përgjatë vitit, KLGJ mund edhe të bëjë rishpërndarje të fondeve mes gjykatave të ndryshme në varësi të nivelit të zbatimit. Përgjatë ciklit buxhetor, përdorimi i përshtatshëm i fondeve duhet të monitorohet dhe auditohet nga KLGJ; ndërkohë që mund të jetë subjekt i auditimit të jashtëm nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Siç vërehet më lart, funksionet e lidhura me procesin e buxhetimit për gjyqësorin janë zhvendosur nga Ministria e Drejtësisë, e cila ka një rol vetëm këshillimor, drejt Këshillit të Lartë Gjyqësor. Megjithatë, në praktikë, ekzekutivi vijon të ruajë një rol vendimtar në përcaktimin e buxhetit, nëpërmjet Ministrisë së Financave e cila ka kompetencën e mbikëqyrësit dhe vendimmarrësit për shumë aspekte të ciklit buxhetor. Këshilli i Lartë Gjyqësor në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë diskutojnë me Ministrinë e Financave një nga fazat kyç të përgatitjes së buxhetit – përcaktimin e taveveve buxhetore. Natyrisht, vendimmarja e shpërndarjes së taveveve buxhetore mbetet prerogativë e Ministrisë së Financave dhe Këshillit të Ministrave, proces në të cilin konkurrenca ndërsektoriale dhe prioritizimi i politikave përkatëse luan një rol të rëndësishëm.

Procesi i buxhetimit në institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë

Institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë, përfshirë Prokurorinë e Përgjithshme; Gjykatën Kushtetuese, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe Shkollën e Magjistraturës janë përgjegjëse për hartimin e kërkesave buxhetore për veprimtarinë përkatëse dhe për përgatitjen e dokumentit të programit buxhetor afatmesëm sipas të njëjtave hapa si KLGJ. Buxheti i secilit prej këtyre institucioneve është ndarë në nga një program të vetëm buxhetor. Në rastin e Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurori i Përgjithshëm ka kompetencën të propozojë dhe administrojë buxhetin e prokurorisë së juridiksionit të përgjithshëm⁴, të përcaktojë strukturën dhe organikën e prokurorive si dhe të hartojë dhe zbatojë këtë buxhet, përfshirë diskutimin dhe mbrojtjen e buxhetit të propozuar gjatë miratimit në kuvend. Në këtë mënyrë, Prokurori i Përgjithshëm parashikon dhe administron burimet e nevojshme dhe ndarjen e tyre sipas nevojave midis prokurorive të ndryshme, në mënyrë të ngjashme me KLGJ-në për buxhetin gjyqësor.

Së fundmi, institucionet e tjera të drejtësisë si Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe institucionet e rivlerësimit, si Komisioneri Publik; Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Apelit kanë buxhetet e tyre të pavarura. Në veçanti, institucionet e rivlerësimit e propozojnë projektbuxhetin e tyre drejtpërdrejt pranë komisionit të çështjeve ligjore pranë Kuvendit, si pjesë integrale të buxhetit të shtetit.⁵ Këto të fundit nuk përgatisin një program buxhetor afatmesëm të mirëfilltë dhe buxheti i tyre është i organizuar kryesisht sipas artikujve të shpenzimit. Veprimtaria financiare e këtyre institucioneve është subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

IV. Përdorimi i treguesve të performancës dhe kriteret për financim në pushtetin gjyqësor

Në një sistem buxhetor me bazë programi dhe performance, përcaktimi i treguesve të performancës së synuar dhe matja e tyre kanë rëndësi të veçantë për të siguruar mbarëvajtjen e sistemit. Për rrjedhojë, ky informacion mund të ndikojë drejtpërdrejt shpërndarjen e burimeve, organizimin e gjyqësorit dhe praktikën e personelit gjyqësor.

Buxheti i sistemit gjyqësor (gjykatave në tre nivele) për periudhën 2025-2027, i cili administrohet nga KLGJ, përfshihet në një program buxhetor të vetëm ku përfshihen gjykatat e të gjitha niveleve, i cili ka si qëllim të politikës së programit “Ofrimin efikas i shërbimeve dhe punë me e mirë nga gjykatat e tre niveleve”⁶. Për këtë periudhë, ky program ka një objektivi dhe tregues performance në nivel objektivi të lidhura me përmirësimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit; përmirësimin e infrastrukturës fizike gjyqësore dhe përqindjen e magjistrateve dhe drejtuesve gra.

Ndërkohë, programi buxhetor i lidhur me funksionim e vetë KLGJ-së, e cila ka funksione themelore për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e sistemit buxhetor, synon “Përmirësimin e sistemit gjyqësor nëpërmjet vendimmarrjes së Këshillit lidhur me miratimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjeve që përbëjnë paketën e reformës në drejtësi si dhe sigurimin e burimeve dhe kapaciteteve financiare të nevojshme”. Treguesit e performancës për këtë program buxhetor janë gjithashtu të përkufizuar ngushtë në lidhje me veprimtarinë e KLGJ-së (2025): a) Akte nënligjore të miratuara nga KLGJ-ja

⁴ Ligji 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38 dhe 40.

⁵ Ligji 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 19.

⁶ Programi Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 faza II <https://financa.gov.al/programi-buxhetor-afatmesem-2025-2027-faza-ii/>

kundrejt totalit të propozimeve; b) Magjistratë të vlerësuar kundrejt vlerësimeve të programuara; dhe c) Përqindja e grave në pozicione drejtuese.

Siç mund të vërehet, është e vështirë të përftohet një pamje e qartë dhe shteruese e aspekteve të efektivitetit dhe eficiencës nga këta tregues performance. Në parim, treguesit e performancës për buxhetin duhet të përfshinin masa të eficiencës (sasia e produkteve – p.sh numri i çështjeve të gjykuara dhe kostot përkatëse); të efektivitetit (shpejtësia e procesit gjyqësor) dhe cilësisë (numri i vendimeve të kthyer, zbatimi i vendimeve). Plani buxhetor përfshin kostot e produkteve, përfshirë edhe kostot për njësi. Me një shqyrtim të PBA-së së programit buxhetor mund të vërehet se kostoja e produktit – në këtë rast kostoja për çështje duket të jetë përlogaritur si një funksion i fondeve të disponueshme përkundrejt çështjeve për t’u gjykuar, me kujdesin që kostoja për njësi të mos ketë luhatje nga viti në vit, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave. Në buxhetin e sistemit gjyqësor parashikohet një rënie e numrit vjetor të çështjeve në shqyrtim nga rreth 150 mijë çështje në vit (2024), në rreth 116 mijë çështje në vit në periudhën 2025 – 2027, çka e çon koston mesatare të një çështjeje nga rreth 28 mijë lekë në rreth 37 mijë lekë për çështje nga viti 2025. Megjithatë, këto vlera janë qartësisht jo domethënëse, pasi buxheti i gjykatave është paraqitur në mënyrë tepër të përmbledhur, pa bërë asnjë dallim mbi juridiksionin apo nivelin e gjykatave; çka ka implikime të rëndësishme mbi kostot e proceseve gjyqësore. Strategjia e KLGJ-së për reduktimin e çështjeve të prapambetura⁷ parashikon rritjen e personelit gjyqësor (magjistratë dhe personel teknik) si një nga zgjidhjet kryesore për uljen e backlog-ut – (i cili ka vazhduar të rritet në veçanti në gjykatat e shkallës së parë gjatë vitit 2023 kryesisht për shkak të mungesës së personelit); deri në plotësimin e tij deri në vitin 2027. Zgjidhjet teknologjike, nëpërmjet zhvillimit dhe instalimit të programeve të menaxhimit të informacionit për digjitalizimin e dosjeve dhe menaxhimin e çështjeve dhe dokumenteve gjitashtu nënvizohen si lehtësues të rëndësishëm të procesit drejt rritjes së performancës. Megjithatë, buxheti afatmesëm i gjyqësorit nuk parashikon rritje në fondin e pagave për periudhën 2025 – 2027 dhe as investime domethënëse në buxhetin e KLGJ-së.

Tregues të rëndësishëm të eficiencës, si mund të jenë koha mesatare e shqyrtimit të çështjes sipas llojit dhe madhësisë së gjykatës; përqindja e gjykatave që tejkalojnë mbi një kufi të caktuar kohëzgjatjen mesatare; numri i çështjeve civile apo penale të gjykuara/zgjidhura për gjyqtar, apo numri i vendimeve të kthyer në apel, mungojnë në programin e përgjithshëm buxhetor. Raporti vjetor i KLGJ-së për vitin 2023 i paraqitur pranë Kuvendit analizon disa prej këtyre aspekteve në mënyrë të përmbledhur, ndonëse nuk ndalet në arsyet për shpërndarjen e ndryshme të ngarkesës, kohëzgjatjen e proceseve, llojin e tyre, apo kostot e ponderuara sipas llojit të çështjeve.

Megjithatë, duhet pranuar se buxheti i sistemit gjyqësor, i cili përfshin një numër të lartë gjykatash në disa nivele në të gjithë Republikën, mund të mos jetë mjaftueshëm i detajuar për arsye të ekonomizimit të kohës dhe dobisë për Ministrinë e Financave – dhe Këshillin e Ministrave. Do të ishte e dëshirueshme që këta tregues performance të përdorreshin si përcaktues të shpërndarjes së buxhetit ndërmjet gjykatave, proces i cili menaxhohet nga KLGJ. Kjo qasje ka pak gjasa që të jetë kthyer në një praktikë: shpërndarja e buxhetit gjyqësor ndërmjet gjykatave bëhet kryesisht në bazë të kostove historike dhe kostove fikse për çdo gjykatë. Siç është shpjeguar më lart, pjesa dërrmuese e shpenzimeve të miratuara për buxhetin e gjyqësorit shkon për shpenzime të lidhura me burimet njerëzore (75% - 80%), ndërkohë që shpenzimet kapitale janë shumë të ulëta, në pritje të vendimmarrjes për racionalizimin e shpërndarjes së gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit të juridiksionit të përgjithshëm.

⁷ Strategjia e uljes së numrit të çështjeve të prapambetura 2024-2027, Këshilli i Lartë Gjyqësor <https://klgj.al/strategjia-e-uljes-se-numrit-te-ceshtjeve-te-prapambetura-2024-2027/>

Përdorimi i **treguesve të performancës** në buxhetimin e drejtësisë është ende i kufizuar. Pavarësisht që në teori buxheti me bazë performancën është adoptuar, shpërndarja e fondeve nuk reflekton efikasitetin e institucioneve. Disa elemente që mungojnë janë:

- Koha mesatare e shqyrtimit të çështjeve sipas llojit të gjykatave
- Norma e kthimit të vendimeve nga gjykatat e apelit
- Ngarkesa mesatare për gjyqtar dhe ndikimi në efikasitetin e vendimeve.

Disa prej këtyre analizave janë cekur shkurtimisht në vlerësimin për hartën e re të gjyqësorit dhe në strategjinë për uljen e çështjeve të prapambetura; por nuk janë integruar ende në procesin e akordimit të burimeve financiare për gjykatat. Në vecanti, procesi i buxhetimit mbetet ende i cekët, për

V. Harta e re gjyqësore dhe implikimet e saj

Harta e re gjyqësore u zbatua në maj - korrik 2023 me synimin për të përmirësuar menaxhimin e gjykatave dhe shpërndarjen e burimeve. Kjo reformë reduktoi numrin e gjykatave nga 38 në 20, duke bashkuar juridiksione dhe duke synuar optimizimin e shërbimeve gjyqësore.

Ndikimi në ngarkesën e punës dhe aksesin në drejtësi:

- Gjykatat e reja të konsoliduara po përballen me rritje të madhe të fluksit të çështjeve, duke krijuar vonesa të konsiderueshme. Ngarkesa e lartë e punës rëndohet më tej nga numri i vendeve vakante për gjyqtarë dhe ndihmës ligjorë në pothuajse të gjitha nivelet e gjykatave.
- Koha e udhëtimit për qytetarët për të aksesuar shërbimet gjyqësore është rritur ndjeshëm, duke rrezikuar ta bëjë sistemin më pak të aksesueshëm për grupe të cënueshme.
- Edhe pse një nga objektivat e reformës ishte reduktimi i kostove, shpenzimet nuk kanë pësuar ndryshime domethënëse pasi numri i gjyqtarëve dhe administratës ka mbetur i lartë dhe parashikohet në rritje deri në plotësimin e vendeve vakante; ndërkohë që kursimet eventuale në shpenzimet e mirëmbajtjes së infrastrukturës dhe mallrave e shërbimeve janë të papërfillshme për shkak të peshës shumë modeste në strukturën e përgjithshme të kostos në gjyqësor.
- Përfitimet eventuale nga zbatimi i hartës së re të gjyqësorit do të materializoheshin në rast të përmirësimit të cilësisë së gjyqimit; në veçanti nëpërmjet sigurimit të trupave gjyqësore dhe stafit mbështetës teknik të aftë, të drejtë e të paanshëm. Në planin afatmesëm është e këshillueshme të kryhet një vlerësim i burimeve njerëzore dhe financiare, barrës së punës për gjykatat e niveleve të ndryshme si edhe treguesit e performancës cilësorë dhe sasiorë.

Kriteret kryesore të vlerësimit të përdorura për këtë riorganizim lidheshin më aksesin në drejtësi: distanca dhe koha e udhëtimit të qytetarëve; ngarkesa e punës për gjyqtarët dhe numri i gjyqtarëve për sallë gjyqi; si edhe tregues të tjerë (të papërcaktuar në mënyrë eksplicite). Përtej konsideratave të përmirësimit të burimeve njerëzore dhe shpërndarjes së ngarkesës dhe llojit të çështjeve në mënyrë më eficiente në gjykata më të mëdha, raporti thekson edhe kursimet eventuale në kosto si një nga avantazhet e pritshme nga konsolidimi i hartës gjyqësore. Vlen të përmendet së nga pikëpamja e eficiencës financiare, të dhënat e përfshira në raport janë të pamjaftueshme për të vlerësuar vërtetësinë e pohimeve, aq më tepër në kushtet kur pjesa kryesore e shpenzimeve gjyqësore është e lidhur në shpenzime për paga dhe nuk pritet të ulet më konsolidimin e gjykatave, meqenëse numri i gjykatësve dhe stafit tjetër gjyqësor nuk pritet të reduktohet.

Mëshumë se një vit nga zbatimi i hartës së re gjyqësore, duket se barra e sistemit gjyqësor në buxhetin e shtetit nuk ka ndryshuar në mënyrë domethënëse. Gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm zënë peshën kryesore në buxhetin e gjykatave (rreth 50% në vitin 2024), me një rritje në terma nominalë dhe relativë, pavarësisht reduktimit të numrit të gjykatave nga 22 në 13 në mesin e

vitit 2023. Gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm trajtojnë numrin më të madh të çështjeve dhe punësojnë numrin më të lartë të gjyqtarëve dhe personelit gjyqësor në system. Në vitin 2023, 132 gjyqtarë ishin në detyrë pranë këtyrë gjykatave, përkundrejt 235 pozicioneve sipas organikës. Kjo tregon që me ecurinë e mëtejshme të reformës dhe plotësimin e vendeve vakante, buxheti i këtyrë gjykatave do të vijojë të rritet. Në vitin 2022, para rikonfigurimit të rretheve gjyqësore, pagat përbënin rreth 82% të shpenzimeve të përgjithshme në gjykatat e shkallës së parë, ose 1.13 miliardë lekë. Në vitin 2024, pagat arritën në 1.87 miliardë lekë (85% të buxhetit). Natyrisht, rritjet e njëpasnjëshme të pagave në sektorin public në përgjithësi, të cilat u pasqyruan edhe në gjyqësor, kanë pasur një efekt të ndjeshëm në buxhetin gjyqësor. Me plotësimin gradual të vendeve vakante, pritet që fatura financiare të rritet edhe më tej.

Nga pikëpamja e efikasitetit të reformës, vlen të përmendet se ka pasur një ulje të lehtë të investimeve – nga rreth 50 milionë lekë në vitin 2022, në 25 milionë lekë në vitin 2024. Këto v lera duhet të interpretohen me shumë kujdes; se pari, bëhet fjalë për shuma modeste, të cilat me gjasë janë dedikuar për riparime e pajisje të godinave e zyrave të gjykatave- Me uljen e numrit të gjykatave, nevoja për këto pajisje ëshët ulur disi. Megjithatë, në raportin vjetor 2023, KLGJ tërjeq vëmendjen për faktin se infrastruktura fizike e gjykatave (në të gjitha nivelet) është shumë e vjetëruar dhe nevoja për investime urgjente. Gjykatat që kanë marrë në dorëzim kompetenca të reja nuk kanë pasur hapësira dhe staf të mjaftueshëm për të përballuar rritjen e ngarkesës dhe fondet e buxhetit gjyqësor nuk kanë qenë të mjaftueshme për të mbuluar nevojat e reja të krijuara nga reforma.

Tabela 5 Buxheti i gjyqësorit sipas lgjykatave 2022 - 2025

	2022		2023		2024		2025	
Mln lekë	Faktik	Miratuar	Faktik	Miratuar	Faktik	Miratuar	Faktik	Miratuar
03310 Veprimtaria gjyqësore	2 661,2	3 454,8	3 006,1	3 966,4	4 355,7	4 541,6	4 417,1	5 628,5
1029001 Keshilli i Larte Gjyqesor	179	657	406	1 291	482	648	479	1 614
Gjykatat e apelit	395,7	444,3	417,8	248,6	493,4	521,3	495,7	456,8
Gjykata e apelit Tirane	139	163	188	200	465	521	496	457
Gjykata e apelit Durres	65	72	51	14	6	-	-	-
Gjykata e apelit Gjirokaster	37	39	30	7	3	-	-	-
Gjykata e apelit Korce	37	36	35	7	5	-	-	-
Gjykata e apelit Shkoder	56	65	56	10	8	-	-	-
Gjykata e apelit Vlore	62	69	58	11	6	-	-	-
Gjykatat e shkallës së parë	1 387,7	1 479,5	1 382,4	1 508,8	2 120,2	2 088,6	2 199,9	2 167,2
Gjykata e shkallës së parë Tirana	411	428	422	500	680	622	704	652
Gjykata e shkallës së parë Berat	53	56	54	65	84	77	97	76
Gjykata e shkallës së parë Dibra	30	34	33	46	68	81	65	82
Gjykata e shkallës së parë Durres	89	103	86	125	167	180	180	193
Gjykata e shkallës së parë Elbasan	86	90	81	97	123	143	155	152
Gjykata e shkallës së parë Fier	73	77	70	95	139	162	177	173
Gjykata e shkallës së parë Gjirokastra	38	41	38	46	77	78	79	81
Gjykata e shkallës së parë Korca	72	75	62	86	136	160	157	146
Gjykata e shkallës së parë Kukes	27	29	24	32	56	91	74	99
Gjykata e shkallës së parë Lezha	40	44	42	44	87	102	100	97
Gjykata e shkallës së parë Saranda	35	39	36	44	58	63	61	68
Gjykata e shkallës së parë Shkodra	83	86	80	91	157	147	159	160
Gjykata e shkallës së parë Vlora	91	96	98	109	177	184	191	188

Gjykata e shkallës së parë Kavaja	27	33	26	15	12	-	-	-
Gjykata e shkallës së parë Kruja	29	32	27	15	13	-	-	-
Gjykata e shkallës së parë Lac	32	33	33	16	14	-	-	-
Gjykata e shkallës së parë Lushnja	36	38	37	18	15	-	-	-
Gjykata e shkallës së parë Mat	30	31	29	14	13	-	-	-
Gjykata e shkallës së parë Permet	27	28	25	12	11	-	-	-
Gjykata e shkallës së parë Pogradec	32	33	30	14	12	-	-	-
Gjykata e shkallës së parë Puka	20	28	23	11	10	-	-	-
Gjykata e shkallës së parë Tropoja	26	27	26	14	11	-	-	-
	-	-	-	-	-	-	-	-
1029041 Gjykata e larte	189,3	311,5	269,5	331,8	374,6	401,1	386,2	431,3
	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjykata penale	167,4	209,8	210,9	286,6	368,9	401,8	376,6	492,1
Gjykata penale e apelit Tirane	57	76	85	135	152	142	131	153
Gjykata penale e shkalles së parë	110	134	126	152	217	260	246	340
	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjykata administrative	341,5	353,0	319,0	299,7	516,1	480,6	479,7	466,7
Gjykata administrative e apelit Tirane	109	112	93	110	156	153	148	162
Gjykata administrative Tirana	98	98	96	98	218	232	232	212
Gjykata administrative Lushnje	-	-	-	-	49	96	100	93
Gjykata administrative Durres	25	30	23	17	14	-	-	-
Gjykata administrative Gjirokastra	28	30	27	19	24	-	-	-
Gjykata administrative Korca	26	28	27	19	19	-	-	-
Gjykata administrative Shkodra	27	28	25	17	17	-	-	-
Gjykata administrative Vlora	28	28	27	19	18	-	-	-

Situata është disi e ngjashme në gjykatat e apelit: Pësia e pagave në totalin e buxhetit (përfshirë gjykatën administrative të apelit) është rritur lehtësisht nga 88% (273.2 milionë lekë) në vitin 2022, në 90% ose 346.5 milionë lekë. Në vitin 2023 ishin vetëm 23 gjyqtarë në detyrë në gjykatat administrative të shkallës së parë, me 13 vende vakante. Shifrat tregojnë se kapaciteti i këtyre gjykatave nuk është i mjaftueshëm për të përballuar fluksin e çështjeve.

Në përgjithësi, mungesa e gjyqtarëve mbetet problem madhor, veçanërisht në gjykatat e apelit dhe shkallës së parë. Delegimet dhe transferimet e gjyqtarëve kanë ndihmuar përkohësisht, por nuk janë një zgjidhje e qëndrueshme për mungesën e burimeve njerëzore. Gjykatat e posaçme kanë nevojë për më shumë gjyqtarë, pasi ende nuk kanë arritur kapacitetin e plotë të organikës së tyre. Numri i stafit administrativ është i pamjaftueshëm, duke ndikuar në ritmin e procedurave gjyqësore dhe menaxhimit të gjykatave. Në përgjithësi, sistemi gjyqësor shqiptar vazhdon të funksionojë me kapacitete të reduktuara, gjë që ndikon në efikasitetin dhe aksesin në drejtësi. Për të zgjidhur këto probleme, nevojiten më shumë rekrutime, rritje e kapaciteteve administrative dhe rritje e financimit për gjyqësorin.

Strategjia e re e drejtësisë 2025 – 2030 specifikon qëllimet kryesore strategjike për një sistem drejtësie të pavarur, llogaridhënës, të aksesueshëm, transparent dhe efikas, duke llogaritur një kosto të përgjithshme prej 6 miliardë lekësh për zbatim, kryesisht për investime në infrastrukturë (54% e kostonë së vlerësuar).⁸

VI. Përfundime

Burimet financiare në dispozicion të sistemit të drejtësisë në Shqipëri janë rritur në mënyrë të qëndrueshme gjatë viteve të fundit. Midis viteve 2018 – 2024 sistemi gjyqësor ka pasur burime të akorduara që arrijnë mesatarisht 0,19% të PBB-së (përjashtuar institucionet kalimtare) dhe sistemi i prokurorisë mesatarisht 0,16% të PBB-së. Akordimi i burimeve për drejtësinë nuk ka lidhje të fortë me nevojat e ofrimit të shërbimit. Masa dhe përbërja e buxhetit bazohet në nivelet historike të inputeve, të cilat korrigjohen në raste ndryshimesh të mëdha, siç ishte për shembull rishikimi i niveleve të pagave për gjyqësorin me fillimin e reformës. Në vazhdim, akordimi i burimeve nuk kryhet mbi bazën e parashikimit për ngarkesën me çështje, rezultate të pritshme apo standarde të tjera. Sistemi nuk përfshin nxitës apo mundësi për të përmirësuar efektivitetin në përdorimin e burimeve. Shpenzimet e pagave mbizotërojnë buxhetin e gjyqësorit dhe sistemit të prokurorisë; duke ngushtuar mundësitë për shpenzime në fusha të tjera si trajnimet apo ekspertizat e ndryshme. Në veçanti, shpenzimet kapitale në sektor nuk kanë ndjekur të njëjtin ritëm rritjeje si shpenzimet e personelit gjatë viteve të fundit, duke u fokusuar kryesisht në ndërhyrje për përmirësimin dhe zgjerimin e infrastrukturës fizike të godinave dhe mjediseve të gjykatave.

Kuadri ligjor i menaxhimit të shpenzimeve publike në Shqipëri ofron një sërë instrumentesh të vlefshëm për të përmirësuar performancën në ofrimin e shërbimeve. Megjithatë, zbatimi i plotë i këtij kuadri kërkon zhvillimin e kapaciteteve të përshtatshme për identifikimin, mbledhjen dhe monitorimin e të dhënave për proceset gjyqësore dhe administrimin gjyqësor. Sistemet e informacionit për drejtësinë janë në zhvillim e sipër dhe është e rëndësishme që të sigurohet lidhja edhe me sistemet e menaxhimit të informacionit financiar. Në parim, informacioni dhe të dhënat për veprimtarinë e

⁸ <https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2025/01/Vendim-nr.787-date-18.12.2024-Per-miratimin-e-Strategjise-Ndersektoriale-te-Drejtësisë-2024-2030-1.pdf>

gjykatave duhet të luajnë një rol më domethënës në përgatitjen e buxheteve dhe vendimeve të lidhura me shpërndarjen e burimeve, duke mundësuar një balancë të përshtatshme mes kostove publike dhe kostove të shtuara për individët dhe aksesin e tyre në drejtësi.

Buxheti i sistemit të drejtësisë është në parim i pavarur. Megjithatë, inefficiencat e lidhura me procesin e hartimi dhe miratimit të buxhetit, strukturës së shpenzimeve, infrastrukturës së vjetëruar dhe (mos) njohjes së plotë të kostove të lidhura me shërbimet e ofruara e ngushtojnë në mënyrë të konsiderueshme diskrecionin faktik të gjykatave mbi buxhetet e tyre.

Megjithatë, aplikimi i buxhetit me bazë performance nuk pritet dhe nuk duhet të çojë në standardizimin e tepruar të tipareve të funksionimit të gjykatave, përfshirë edhe kostot për çështje gjyqësore, çka mund të interpretohet nga gjykatësit si ndërhyrje në autonomi apo të shërbejnë si kundërnxitës – për shembull duke sugjeruar përshtypjet e tepërt të procedimeve në kurriz të cilësisë. Është e rëndësishme të theksohet se informacioni financiar duhet të interpretohet krahas dhe në funksion të informacionit cilësor dhe të bëhet pjesë përbërëse e raportimeve dhe analizave të punës së institucioneve të drejtësisë.

Rekomandime

Financimi i sistemit të drejtësisë në Shqipëri ka ndjekur një trajektore në rritje gjatë viteve të fundit, duke reflektuar përpjekjet për të përmirësuar administrimin gjyqësor dhe për të përballuar sfidat e reformës në drejtësi. Megjithatë, pavarësisht rritjes së alokimeve buxhetore, sfidat kryesore të sistemit vazhdojnë të mbeten: mungesa e burimeve njerëzore, rritja e ngarkesës së punës, nevoja për investime infrastrukturore dhe mungesa e një lidhjeje të qartë mes financimit dhe rezultateve të arritura. Rekomandohet që shpërndarja e fondeve të bazohet më shumë në tregues konkretë të performancës si koha mesatare e shqyrtimit të çështjeve, cilësia e vendimeve, dhe produktiviteti i gjykatave. Kjo do të siguronte që fondet të përdoren më efektivisht dhe të nxisnin eficiencën.

Ndërhyrja më e rëndësishme që kërkon vëmendje është menaxhimi më i efektshëm i burimeve. Në një sistem ku pjesa më e madhe e buxhetit përdoret për pagat e gjyqtarëve dhe administratës, mbeten pak mundësi për investime në përmirësimin e infrastrukturës dhe digjitalizimin e proceseve gjyqësore, të cilat mund të rrisin ndjeshëm efikasitetin dhe transparencën e sistemit. Për më tepër, ndarja e fondeve midis institucioneve të ndryshme të drejtësisë nuk bazohet në nevoja të qarta operationale apo objektiva të matshëm të performancës, por më tepër ndjek modele historike të financimit.

Një tjetër aspekt që kërkon përmirësim është analiza e impaktit të hartës së re gjyqësore. Konsolidimi i gjykatave dhe riorganizimi i juridiksioneve kishte për qëllim të shpërndante më mirë ngarkesën e punës dhe të reduktonte kostot, por deri më tani efektet e tij nuk janë të qarta. Ndërkohë që numri i gjykatave është reduktuar, kostot e sistemit gjyqësor nuk kanë ndryshuar ndjeshëm, dhe aksesin në drejtësi është bërë më sfidues për qytetarët në disa rajone. Këto elemente duhet të analizohen më tej për të parë nëse reforma ka dhënë rezultatet e pritura. Në këtë kontekst, rekomandohet një qasje më e strukturuar për menaxhimin dhe shpërndarjen e burimeve në sektorin e drejtësisë. Së pari, duhet të zhvillohen mekanizma më të mirë për matjen e performancës, duke përfshirë tregues që matin kohëzgjatjen e çështjeve, cilësinë e vendimeve dhe ngarkesën e punës për gjyqtar. Së dyti, është e nevojshme të investohet më shumë në teknologji dhe digjitalizimin e sistemit gjyqësor për të përshtypuar proceset dhe për të ulur kostot e administrimit. Së treti, duhet të bëhet një rishikim më i thelluar i hartës gjyqësore në periudhën nafatmesme, duke analizuar ndikimin e saj real në sistem dhe duke bërë rregullime aty ku është e nevojshme për të garantuar një drejtësi më efikase dhe të aksesueshme për të gjithë qytetarët.

Përfundimisht, një sistem drejtësie i mirë-financuar nuk mund të sjellë rezultate efektive pa një menaxhim të mirë-strategjizuar të burimeve dhe pa lidhjen e drejtpërdrejtë të fondeve me performancën reale të sistemit. Vetëm një qasje e integruar që kombinon planifikimin e mirë-buxhetuar, teknologjinë dhe matjen e performancës do të mundësojë një drejtësi më efikase dhe më të aksesueshme për qytetarët.